

VENDIM
Nr. 868, datë 30.12.2024

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 597, DATË 13.10.2021, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PERSONALITETEVE DHE OBJEKTEVE TË
TJERA, QË RUHEN DHE MBROHEN NGA GARDA E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 12, pika 1, shkronjat “a” e “d”, dhe pika 2, shkronja “d”, dhe 13, pika 4, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën “j”, të pikës 1, të vendimit nr. 597, datë 13.10.2021, të Këshillit të Ministrave, pas fjalëve “... kryetarin e komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ...” shtohen “... deri më 31 dhjetor 2025 ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku